

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR PËR VITIN 2024

Kuvendi i Republikës Shqipërisë,

Duke vlerësuar rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në sigurimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë dhe mbarëvajtjes së pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë;

Duke mbajtur parasysh rolin e Këshillit të Lartë Gjyqësor në emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe riemërimin, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin e gjyqtarëve të të gjitha niveleve;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkollën e Magistraturës, sidomos për trajnimin vazhdues të gjyqtarëve dhe emërimin e gjyqtarëve pas diplomimit në Shkollën e Magistraturës;

Duke theksuar rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në drejtimin dhe kujdesjen për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me fokus hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të politikave për administrimin gjyqësor, monitorimin dhe menaxhimin e ngarkesës së gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve dhe miratimin e rregullave të brendshme standarde të gjykatës;

Duke mbajtur në konsideratë nevojat e Këshillit për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor;

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e informimit të publikut dhe Kuvendit për gjendjen e sistemit gjyqësor,

Bazuar në analizën e të dhënave të vitit 2024, të referuara në raportin e paraqitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, konstaton:

Zhvillimin e 65 mbledhjeve plenare dhe miratimin e 764 vendimeve.

Miratimin e Strategjisë për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura në Gjykata (2024–2027). Strategjia përcakton 7 objektiva, për zbatimin e të cilave nga ana e Këshillit janë miratuar një tërësi aktesh nënligjore.

Realizimin e vlerësimeve etiko-profesionale të gjyqtarëve si proces të lidhur ngushtë me zhvillimin e karrierës së tyre. Miratimin e 34 raporteve të vlerësimit, ndërsa gjatë periudhës 2020–2024 janë miratuar në total 190 raporte vlerësimi (nga të cilët, 78 gjyqtarë janë vlerësuar për 2 periudha vlerësimi dhe 41 gjyqtarë janë vlerësuar për 1 periudhë vlerësimi) për 119 gjyqtarë, duke vlerësuar rreth 63% të gjyqtarëve për 303 procedura vlerësimi të filluara.

Angazhimin në përgatitjen dhe rekrutimin e gjyqtarëve të rinj përmes emërimit të 32 magistratëve të rinj, të cilët kanë përfunduar programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magistraturës për vitin akademik 2023–2024; miratimit të 20 kuotave për kandidatë për magistratë profili “gjyqtar” dhe të 15 kuotave për kandidatë për “ndihmës ligjorë” për vitin akademik 2024–2025; verifikimit të kriterëve dhe kushteve formale-ligjore, si dhe të pasurisë dhe figurës për 56 kandidatë.

Finalizimin e 4 procedurave të ngritjes në detyrë në gjykatat që kanë edhe stokun më të lartë të çështjeve në pritje për gjykim në sistemin gjyqësor, 3 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; dhe 1 në Gjykatën Administrative të Apelit.

Caktimin e 66 gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme; 2 gjyqtarëve në skemën e delegimit në Gjykatën Administrative të Apelit; transferimin në mënyrë të përkohshme të 21 gjyqtarëve, si dhe transferimin në mënyrë të përhershme, për shkak të suprimimit të pozicionit, për 6 gjyqtarë të tjerë.

Angazhimin në kuadër të rritjes së transparencës dhe forcimin e besimit të publikut përmes trajtimit të kërkesave për të drejtën e informimit; përditësimit të vazhdueshëm të të dhënave për publikun, mbi zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve, vendimmarrjet e Këshillit, si dhe njoftimet dhe aktivitetin e tij.

Miratimin e vendimeve që kanë siguruar vazhdimësinë e funksionit të gjyqtarëve të medias, pavarësisht lëvizjeve paralele apo ngritjeve në detyrë të gjyqtarëve.

Zbatimin e reformës për nëpunësin civil gjyqësor përmes miratimit të akteve strategjike dhe nënligjore me fokus nëpunësin civil gjyqësor, si dhe ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullave dhe vlerësimin e kategorive të nëpunësve civilë gjyqësorë.

Trajtimin e procedimeve disiplinore të reja gjatë vitit 2024, si dhe 5 çështje të mbartura nga vitet e mëparshme.

Mbështetjen e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit, përmes përpjekjeve për plotësimin e vakancave, krijimin e infrastrukturës mbështetëse, si dhe standardizimin e pajisjeve *hardware*.

Rritjen e kapaciteteve profesionale për gjyqtarët dhe stafin administrativ.

Analizën për situatën e gjykatave në vend.

Bashkëpunimin ndërinstitucional me shumë aktorë, si dhe zhvillimin e takimeve me përfaqësues të diplomacisë dhe ekspertë ndërkombëtarë.

Bashkëpunimin në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësim në BE nëpërmjet raportimit të zhvillimeve kryesore dhe rezultateve të arritura, si dhe përditësimit të masave të kërkuara nga Bashkimi Evropian por edhe nga Kuvendi i Shqipërisë, me qëllim përmbushjen e rekomandimeve të kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, si dhe kapitullit 24 “Drejtësia, liria dhe siguria”.

Vijimin e ndjekjes dhe zbatimit të Planit të Komunikimit për Gjykatat, nëpërmjet raportimeve periodike të gjykatave, lidhur me zbatimin e objektivave strategjikë që përmbante ky plan, duke kontribuar në përmirësimin e komunikimit me publikun dhe mediat.

Kuvendi i Shqipërisë i rekomandon Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2025, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të bëjë një analizë mbi gjetjet dhe rekomandimet e BE-së (raport progresi dhe raporti “*Rule of Law*”) dhe angazhimeve të marra në kuadrin e procesit të negociatave. Përfundimet e kësaj analize t’ia bëjë të njohur Kuvendit brenda muajit dhjetor 2025.

2. Të përmirësojë mekanizmat e mbledhjes dhe analizës së të dhënave statistikore mbi funksionimin e gjykatave, për të siguruar transparencë, krahasueshmëri dhe raportim të standardizuar sipas udhëzimeve të CEPEJ.

3. Të intensifikojë monitorimin e zbatimit të planit të reduktimit të çështjeve të prapambetura (*backlog*), duke përcaktuar objektiva të matshëm për çdo gjykatë dhe duke raportuar periodikisht mbi progresin e arritur.

4. Të përmirësojë procesin e vlerësimit të performancës së gjyqtarëve, në mënyrë që të garantojë objektivitet, transparencë dhe lidhje të qartë ndërmjet vlerësimit dhe avancimit në karrierë.

5. Të forcojë masat për rritjen e integritetit gjyqësor, duke përfshirë programe trajnimi mbi etikën, konfliktin e interesit dhe komunikimin publik.

6. Të sigurojë ndarjen e balancuar të ngarkesës së punës ndërmjet gjykatave dhe gjyqtarëve, në mënyrë që të garantohet efikasiteti dhe barazia në trajtimin e çështjeve.

7. Të përmirësojë bashkëpunimin ndërinstitucional me Shkollën e Magjistraturës dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë për të harmonizuar proceset e emërimit, trajnimit dhe vlerësimit të magistratëve.

8. Të rrisë transparencën në procesin e komandimeve dhe emërimeve të përkohshme, duke siguruar respektimin e parimit të meritokracisë dhe shmangien e praktikave arbitrare.

9. Të intensifikojë masat për përmirësimin e infrastrukturës së gjykatave dhe kushteve të punës së gjyqtarëve, dhe veçanërisht sigurinë në të gjitha gjykatat e vendit, duke përmirësuar bashkëpunimin ndërinstitucional me Kuvendin dhe institucionet e ekzekutivit përmes Ministrisë së Drejtësisë.

10. Të zbatojë masat për digjitalizimin e plotë të procesit gjyqësor, përfshirë sistemin e regjistrimit elektronik të çështjeve, nënshkrimin elektronik dhe komunikimin elektronik me palët.

11. Të përgatisë raporte periodike mbi zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit, duke e bërë këtë një pjesë integrale të procesit vjetor të raportimit.

12. Të përgatisë brenda muajit dhjetorit 2025 një analizë krahasuese të çështjeve gjyqësore të mbartura (*backlog*) përpara dhe pas reformës në drejtësi, përfshirë krahasimet me vendet e tjera të rajonit dhe me standardet e CEPEJ, me qëllim vlerësimin objektiv të ecurisë së sistemit gjyqësor dhe identifikimin e nevojave për ndërhyrje të mëtejshme ligjore dhe institucionale.

13. Të raportojë mbi ecurinë e përgatitjes dhe miratimit të rregulloreve të parashikuara në ligj, duke adresuar pengesat që ndikojnë në përmbylljen e kuadrit nënligjor dhe duke siguruar funksionim të plotë institucional.

14. Të hartojë deri në dhjetor 2025 një analizë të plotë të vakancave në sistemin gjyqësor, duke përfshirë gjyqtarët e komanduar dhe nevojat për burime njerëzore, me qëllim hartimin e një plani të unifikuar për rekrutimin, trajnimin dhe sistemimin e gjyqtarëve në të gjitha nivelet e gjyqësorit, si dhe kërkesat për sistemin e rekrutimeve në Shkollën e Magjistraturës, nevojat për staf mbështetës etj.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 30.10.2025.